



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 615/2 prot.

Tiranë, më 28.4.2025

V E N D I M

Nr. 14, datë 28.4.2025

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 12, DATË 25.04.2025 "PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË TESTIT PROFESIONAL DHE KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË TESTIT TË SHËNDETIT MENDOR DHE PSIKOLOGJIK PËR PROVIMIN E PRANIMIT VITI AKADEMIK 2025-2026"

Në mbështetje të nenit 248 dhe 266 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenit 31 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës;

Duke qenë se për arsye shëndetësore të papritura, znj. N P nuk mund të marrë pjesë si anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional dhe Komisionit të Vlerësimit të Testit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik për provimin e pranimit viti akademik 2025-2026, dhe në këto kushte lind nevoja e zëvendësimit të saj;

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur online, më datë 28.4.2025,

V E N D O S I:

1. Të bëjë një ndryshim në përbërjen e Komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë) të Provimit të Pranimit për vitin akademik 2025-2026, duke zëvendësuar znj. N P me z. H L
2. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë) të Provimit të Pranimit për vitin akademik 2025-2026, është si vijon:

|     |   |           |                                    |
|-----|---|-----------|------------------------------------|
| - V | K | (kryetar) | - Procedurë civile                 |
| - S | P |           | - E drejtë civile                  |
| - Y | P |           | - E drejtë penale dhe kazus penal  |
| - H | L |           | - Procedurë penale dhe kazus penal |
| - V | Z |           | - E drejtë familjare               |
| - A | D |           | - Kazus administrativ              |
| - A | V |           | - Kazus Civil                      |

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.